



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 1, datë 03. 02 .2009

**PËR**

**“MIRATIMIN NË PARIM TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËR  
VITET 2009-2011 DHE MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT TË  
BASHKISË SË TIRANËS, PËR VITIN 2009”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1-8 dhe nenit 32, gërma “ç”, “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit 7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit nr. 11, datë 27.02.2008 dhe nr. 11/1, datë 10.07.2008, për “Përgatitjen e buxhetit”, shkresës së Ministrit të Financave nr.11660, datë 06.11.2008 “Njoftim për transfertën e pakushtëzuar të planifikuar për vitin 2009”; pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë në parim Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për vitet 2009-2011 sipas Lidhjes A “Programi Buxhetor Afatmesëm” pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009 sipas Lidhjes B “Buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2009” pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë vijon.
  - 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009, në shumën 7.637.784.000 lekë, të detajuar si më poshtë;

<b>Plani i të ardhurave</b>	<b>Në lekë</b>
<b>Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore</b>	<b>6.670.365.000</b>
– Të ardhura tatimore	4.874.505.000

– Të ardhura jo tatimore	1.795.860.000
<b>Të ardhura nga Granti i pakushtëzuar</b>	<b>967.419.000</b>
<b>Totali</b>	<b>7.637.784.000</b>

2.2 Të miratojë programin e shpenzimeve totale të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009, në shumën 7.637.784.000 lekë, si vijon:

<b>Plani i shpenzimeve</b>	<b>Në lekë</b>
Shpenzime korrente	4.315.596.000
Shpenzime kapitale	3.322.188.000
<b>Totali</b>	<b>7.637.784.000</b>

2.3 Të miratojë detajimin e buxhetit të shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009 sipas Pasqyrave Nr. 1, 1/1, 3, 3/1, 3/2, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.4 Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009 sipas Programeve (shpenzimeve korente dhe kapitale) si në Pasqyrën Nr. 4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.5 Të miratojë nën programin e investimeve sipas programeve për vitin 2009 si në Pasqyrën Nr.5 pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.6 Të miratojë numrin e punonjësve për Njësitë Bashkiake të Tiranës, si dhe çdo institucioni dhe ndërmarrje të varësisë (sipas aneksit bashkëlidhur Nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi).

2.7 Ngarkohet Nëpunësi Autorizues i Bashkisë së Tiranës të kryejë detajimin e fondeve për investime brenda programeve, të miratuara nga Këshilli Bashkiak, në buxhetin e vitit 2009.

2.8 Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2009.

2.9 Të rritet limiti i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009, për diferencat e pa përdorura në të ardhura e shpenzime të vitit 2008, sipas shumës së përcaktuar në akt-rakordimin përfundimtar me Degën e Thesarit Tiranë. Ky fond të përdoret për likuidimin e shpenzimeve në investime, për objektet në vazhdim të pafinancuara nga viti 2008.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Planifikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik e Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e

Prokurimeve e të gjitha strukturat e tjera të Bashkisë, Njësitë Bashkiake, institucionet dhe ndërmarrjet në varësi të saj.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**KRYETAR**